REPUBLIKA E SHQIPËRISË

DREJTORIA E SHËRBIMIT SOCIAL ARSIMIT DHE SHËNDETËSISË

Nr. 1752/1 Dt. 20.3.25

Projekt-Vendim - nr. 6

Për "Dhënien e Ndihmës Financiare pwrfitueswve nga projekti "Shërbime mbështetëse dhe fuqizuese në familje për të moshuarit dhe personat me aftësi të kufizuar" financuar nga Fondi Social"

Në kuadër të projektit "Shërbime mbështetëse dhe fuqizuese në familje për të moshuarit dhe personat me aftësi të kufizuar" me qëllim dhënien e ndihmës financiare për mbulimin e nevojave për shërbim mjekësor për të moshuarit në nevojë, përfitues të këtij projekti financuar nga Fondi Social i Ministrisë së Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale, si dhe në mbështetje të ligjit nr.139 /2015 "Për vetëqeverisjen vendore",i ndryshuar , të nenit 8 pika 2 , nenit 9 nënpika 1.1, gërma "b",ligji nr. 9936, datë 26.06.2008, "Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë", dhe VKB nr. 108 datë 19.12.2024 , "Për miratimin e buxhetit për vitin 2024". i propozojmë Këshillit të Bashkisë Maliq:

I. Miratim ndihmë financiare për shërbime mjekësore për të moshuarit si më poshtë;

Nr.	Emri Mbiemri	ID	Nj.Administrative	Shuma
1	Z.Refat Matraku	D80610038D	Moglicë	20 000 lekë
2	Z.Naim Haxhillari	I70522011N	Libonik	30 000 lekë
	Totali			50 000 lekë

II. Fondi do të përballohet nga buxheti i projektit "Shërbime mbështetëse dhe fuqizuese në familje për të moshuarit dhe personat me aftësi të kufizuar" të financuar nga Fondi Social i Ministrisë së Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale.

III. Për zbatimin e vendimit ngarkohet Drejtoria e Shërbimit Social Arsimit dhe Shëndetësisë dhe Drejtoria e Financës dhe Buxhetit në Bashki.

	(EmërMbiemër)	Nënshkrimi	Data
Konceptoi: Pranoi Drejtoria e Shërbimit Social Arsimit dhe Shëndetësisë	E.Bezati E.Petriti		Dt.20.03.2025 Dt.20.03.2025

KRYETARI I BASHKISË
Gëzim Topçiu

REPUBLIKA E SHQIPËRISË BASHKIA MALIQ

REPUBLIKA E SHQIPËRISË

DREJTORIA E SHËRBIMIT SOCIAL ARSIMIT DHE SHËNDETËSISË

Nr. 1752/1 Dt. 20.3.25

RELACION

Për "Dhënien e Ndihmës Financiare përfituesëve nga projekti "Shërbime mbështetëse dhe fuqizuese në familje për të moshuarit dhe personat me aftësi të kufizuar" financuar nga Fondi Social"

Në kuadër të projektit "Shërbime mbështetëse dhe fuqizuese në familje për të moshuarit dhe personat me aftësi të kufizuar" me qëllim dhënien e ndihmës financiare për mbulimin e nevojave për shërbim mjekësor për të moshuarit në nevojë, përfitues të këtij projekti financuar nga Fondi Social i Ministrisë së Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale, si dhe në mbështetje të ligjit nr.139 /2015 "Për vetëqeverisjen vendore",i ndryshuar , të nenit 8 pika 2 , nenit 9 nënpika 1.1, gërma "b",ligji nr. 9936, datë 26.06.2008, "Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë", dhe VKB nr. 108 datë 19.12.2024 , "Për miratimin e buxhetit për vitin 2025".Gjatë implementimit të projektit janë identifikuar disa raste të cilat kanë nevojë për mjekime të cilat janë të kushtueshmë dhe sigurimi i tyre rendon gjendjen ekonomike te familjeve dhe individëve përfitues të këtij projekti. Dy nga rastet të cilët sipas punonjësve të shërbimit në familje janë konsideruar më emergjente janë si më poshtë:

1. Z.Naim Haxhillari

Z.Naim Haxhillari i datëlindjes 22.05.1947, është banor i fshatit Beras, Njësisa Administrative Libonik, duke qënë se i moshuari jetonte në një banesë të amortizuar dhe shumë larg shërbimeve aktualisht jetonte në një banesë me qera në Qytetin e Maliqit. Në vitin 2023 Shërbimi social Maliq ka asistuar në plotësimin e dokumentacionit për stehimin e tij një një Institucion tën përkujdesit Shoqëror , por në momentin e sigurimit të një vendi ai refuzon të shkojë pasi kërkon të jetojë në Maliq.

Prej asaj kohe është mbështetur nga ana jonë me veshje dhe paketa ushqimore. Për shkak të moshës në datën 05.03.2025 njoftohemi nga Drejtoria Spitalore Korcë se Z.Nemim është shtruar në Spitalin Rajonal Korçë për një periudhe një javore, ku është diagnostifikuar me Kardiomiopati e Dilatuar me ulje severe EF-257, Insuficience Kardiake si dhe Ekzema Stazike Pedis Serprainfection. Ai ka qëndruar aty deri në datën 13.03.2025, ku ka marrë mjekime nga mjeku specialist dhe është referuar tek mjeku i familjes për rishikim të mëtejshëm për trajtimin e tij në banesë. Për shkak se i moshuari nuk ka asnjë të afërm per tu kujdesur për të projekti "Shërbime mbështetëse dhe fuqizuese në familje për të moshuarit dhe personat me aftësi të kufizuar" ka bërë të mundur asistimin për përmirësimin e kushteve higjenike në banesë sigurimin e veshmbathjeve dhe paketa ushqimore, duke qënë se e vetmja e ardhur e tij është pensioni në masën 19709 lekë në muaj, është e nevojëshme mbulimi i një pjesë të medikamenteve që i janë referuar nga mjeku të cilat janë pa rimbursime.

2. Z.Refat Matraku

Z.Refat Matraku i datëlindjes 10.06.1938 është banor i fshatit Popcisht, Njësia Administrative Moglicë, Bashkia Maliq. Z.Refat jetonte në një banesë të lënë nga një banor i fshatit e cila është në gjëndjë të amortizuar pasi ai vetë nuk ka pronë të tijën dhe nuk ka pasur asnjë familje, përvec dy vëllezërve të tij më të cilët nuk ka marrdhënie te mira. Jemi njoftuar nga Kryetari I fshtati lidhur nme gjendjen e rënduar shëndetësiore të tij gjatë kohëve të fundit.

Menjëherë mbas njoftimit punonjësit sociale të shërbimit Social Maliq dhe "Shërbime mbështetëse dhe fuqizuese në familje për të moshuarit dhe personat me aftësi të kufizuar". Duke parë situatën e vështirë kërkuam bashkëpunimin e Qendrës shëndetësore Gorë ku më datën 27.02.2025 i është bërë vizitë nga ana jonë dhe nga mjeku i familjes për të parë gjendjen shëndetësore. Menjëherë mbas konstatimit të gjendjes shëndetësore mjeku i familjes rekomandon dhënien e ndihmës mjekësore më të specializuar duke e shtruar në Spitalin Rajonal Korçës me ndihmën e ambulancës. Ai qëndroi në pavionin e kardiologjise për 12 ditë ku mori edhe mjekimin e nevojshëm pasi u diagnostifikua se vuan nga disa sëmundje si Insuficiencë Kardiake dhe Fibrilacion Permanent. Duke parë gjendjen shëndetësore dhe të banesës ku jetonte jemi mundur të sigurojmë një ambjent më të përshtatshëm për të. Gjatë vlerësimit të rastit kemi komunikuar me mbesën e tij në fshatin Pojan, Njësia Administrative Pojan, e cila u shpreh e gatëshme për ta ndihmuar dhe për ti siguruar strehim menjëherë mbas daljes nga spitali.

Duke qënë se edhe mbesa ka problemet e saj ekonomike dhe me 3 fëmijë të vegjël nëpërmjet projektit i mundësojmë sigurimin e një pjese të medikamenteve të nevojëshme të rekomanduara nga mjeku të cilat nuk janë me rimbursim.

Gjithashtu për sa kohë që do të jetë i strehuar në banesën e mbesës ne do të kujdesemi për t'i siguruar një paketë ushqimore periodike dhe veshmbathjeve sipas nevojës.

	(EmërMbiemër)	Nënshkrimi	Data
Konceptoi:	E.Bezati		Dt.20.03.2025
Pranoi Përgj. Sekt. të Shërbimit Social dhe Strehimit	E.Petriti		Dt.20.03.2025

KRYETARI I BASHKISË
Gëzim Topçiu